



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS FUSHË KOSOVE**

---

Numri i lëndës: 2021:138354

Datë: 26.07.2023

Numri i dokumentit: 04526271

PPP.nr.751/2021

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – DEGA NË FUSHË KOSOVË, gjyqtari Freskim Musliu, në çështjen përmbarimore të kreditorit X . K . nga Prishtina, , të cilin e përfaqëson avokat N . P. nga Prishtina, ndaj debitorëve të përmbarimit “P . . .” Sh.P.K., me seli në Prishtinë , dhe “O . . . “ Sh.P.K., me seli në Fushë Kosovë, zona industriale, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të përmbarimit të ushtruar kundër urdhrit përmbarimor P.nr.145/21, të datës 23.04.2021 të përmbaruesit privat I . K . nga Prishtina, jashtë seancës me datë 25.07.2023, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

PËRFUNDOHET procedura përmbarimore P.nr.145/21 te përmbaruesi privat I . K . nga Prishtina, në çështjen përmbarimore ndemjet kreditorit të përmbarimit X . K . nga Prishtina dhe debitorëve të përmbarimit “P . . .” Sh.P.K., me seli në Prishtinë dhe “O . . . “ Sh.P.K., me seli në Fushë Kosovë, për shkak të pagesës së borxhit në tërësi nga debitorët.

**A R S Y E T I M**

Përmbaruesi privat I . K . nga Prishtina me datë 23.04.2021 ka nxjerrë urdhrin përmbarimor P.nr.145/21, me të cilin në bazë të propozimit të kreditorit të përmbarimit X . K . ka caktuar përmbarimin në shumë prej 163,022.58 euro, si dhe kamatëvonesën vjetore prej 8%, kundër debitorëve të lartcekur. Përmbarimi është caktuar në bazë të faturës me numër F-02-Q/2021, e datës 02.04.2021 dhe debit notave me numër CN.01.Q/2021 dhe CN-02-Q/2021 të datave 02.04.2021.

Debitori "P . . ." Sh.P.K. me datë 06.05.2021 ka ushtruar prapësim ndaj urdhrin përbarimor të lartcekur dhe ka kërkuar nga kjo gjykatë që ta anuloj urdhrin dhe të detyrohet kreditori t'i paguajë shpenzimet e procedurës. Kreditori ka paraqitur përgjigje në prapësim, me të cilin ka kërkuar që të refuzohet prapësimi i debitorit.

Më 30.09.2022 gjykata ka pranuar me shkrim njoftimin nga përbaruesi privat i lartcekur, me të cilin e ka njoftuar gjykatën që debitori e ka përmbushur detyrimin, e këtij njoftimi i ka bashkëngjitur edhe parashtrësat nga kreditori dhe debitori, me të cilat njoftohet përbaruesi se detyrimi është përmbushur.

Meqenëse kërkesa e kreditorit është realizuar jashtë procedurës së përbarimit, atëherë gjykata në bazë të nenit 66 para. 4 të LPP-së sipas detyrës zyrtare e përfundoi procedurën përbarimore, si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – DEGA NË FUSHË KOSOVË

Departamenti i Përgjithshëm

PPP.nr.751/2021, me datë 26.07.2023

Gjyqtari

Freskim Musliu

**UDHËZIMI JURIDIK:** Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë, Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afatin prej 7 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit, përmes kësaj gjykate.